

Në bazë të nenit 54, paragrafi (1), pika 1), nënpika 1.20 të Ligjit të Energjetikës* ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/25 dhe 135/25), nenit 8 paragrafi (2) të Rregullores së Formimit të Çmimeve më të Larta të Shitjes me Pakicë të Derivateve të Ndryshme të Naftës dhe të Karburanteve për Transport ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 108/20, 133/20, 49/22, 54/22, 64/22, 125/22, 218/25, 48/26, 60/26 dhe 87/26) dhe Vendimit për Përcaktimin e Dendësisë së Përshkallëzuar ρ_e dhe Dendësisë së Pashkallëzuar ρ_d të Secilit Derivat të Naftës dhe të Lëndës Djegëse të Transportit, Shumës së Kompensimit P për Premi, Shpenzimeve të Transportit T Deri te Depozita e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Shumës së Kompensimit D për Kompensime për Punën Përmes Depozitës dhe Marzhës Tregtare me Shpenzime të Përfshira të Transportit nga Depozita Deri te Pikat e Karburantit dhe te Konsumatorët e Fundëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.109/26) Komisioni Rregullator i Energjetikës, i Shërbimeve të Ujit dhe i Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 1.6.2026, solli këtë

V E N D I M

për përcaktimin e çmimeve më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit

Neni 1

(1) Çmimet më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit janë:

- Benzinë motori - EUROSUPER BS - 95	-	88,00 (denarë/litër)
- Benzinë motori - EUROSUPER BS – 98	-	90,00 (denarë/litër)
- Naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)	-	85,50 (denarë/litër)
- Vaj për djegie - EKSTRA I LEHTË 1 (EL-1)	-	87,50 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	47,906 (denarë/kilogram)

(2) Tregtarët me shumicë dhe pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit, mund të formulojnë çmime edhe më të ulëta të derivateve të ndryshme të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit, nga çmimet më të larta të përcaktuara sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të formuara në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, përveç çmimit të Mazutit M-1 SU, vlejnjë për franko stacion të pompimit, ndërsa çmimi i Mazutit M-1 SU vlen për franko depozitë të tregtarit me shumicë me derivate të naftës dhe lëndë djegëse të transportit në vend.

(4) Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të formuluara sipas këtij neni, përfshihet edhe tatimi i vlerës së shtuar sipas Ligjit të Tatimit të Vlerës së Shtuar.

Neni 2

(1) Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit, të përcaktuara sipas nenit 1 të këtij vendimi, janë përfshirë edhe çmimet më të larta të blerjes, të cilat arrijnë vlerën prej:

- Benzinë motori - EUROSUPER BS - 95	-	45,736 (denarë/litër)
- Benzinë motori - EUROSUPER BS – 98	-	47,430 (denarë/litër)
- Naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)	-	50,880 (denarë/litër)
- Vaj për djegie - EKSTRA I LEHTË 1 (EL-1)	-	50,725 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	36,708 (denarë/kilogram)

Neni 3

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi, përfshihet edhe kompensimi për shpenzime për punën përmes depozitës dhe marzhës tregtare, e cila për Eurosuperin BS-95 është 6,870 denarë/litër, për Eurosuperin BS-98 është 6,871 denarë/litër, për Eurodizelin BS (D-E V) është 6,748 denarë/litër dhe për Vajin Ekstra të Lehtë 1 (EL-1) është 6,588 denarë/litër, ndërsa për Mazutin M-1 SU kompensimi është 3,000 denarë/kilogram.

Neni 4

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi, me përjashtim të Mazutit M-1 SU, përfshihet edhe kompensimi për shpenzime të transportit nga depozita deri te pikat e karburantit në shumë prej 1,00 denarë/litër për të gjitha derivatet e naftës.

Neni 5

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të përcaktuara sipas nenit 1 të këtij vendimi, është i përfshirë edhe kompensimi për financimin e aktiviteteve nga fusha e mjedisit jetësor, që sipas nenit 184, paragrafi (1), të Ligjit të Mjedisit Jetësor, e paguajnë tatimpaguesit e përcaktuar me këtë ligj:

- Benzinë motori - EUROSUPER BS - 95	-	0,080 (denarë/litër)
- Benzinë motori - EUROSUPER BS – 98	-	0,080 (denarë/litër)
- Naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)	-	0,030 (denarë/litër)
- Vaj për djegie - EKSTRA I LEHTË 1 (EL-1)	-	0,040 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	0,050 (denarë/kilogram)

Neni 6

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të përcaktuara sipas nenit 1 të këtij vendimi, është përfshirë edhe kompensimi për rezervat e detyrueshme, të cilin në pajtueshmëri me nenin 32, paragrafi (1) të Ligjit të Rezervave të Detyrueshme të Naftës dhe të Derivateve të Naftës, e paguajnë prodhuesit e derivateve të naftës dhe importuesit e derivateve të naftës:

- Benzinë motori - EUROSUPER BS - 95	-	0,890 (denarë/litër)
- Benzinë motori - EUROSUPER BS – 98	-	0,890 (denarë/litër)
- Naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)	-	0,300 (denarë/litër)
- Vaj për djegie - EKSTRA I LEHTË 1 (EL-1)	-	0,300 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	0,740 (denarë/kilogram)

Neni 7

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të përcaktuara sipas nenit 1 të këtij vendimi, akcizat që i paguajnë tatimpaguesit në pajtueshmëri me rregullat e akcizave kanë këto vlera:

- Benzinë motori - EUROSUPER BS - 95	-	20,00 (denarë/litër)
- Benzinë motori - EUROSUPER BS – 98	-	20,00 (denarë/litër)
- Naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)	-	13,50 (denarë/litër)
- Vaj për djegie - EKSTRA I LEHTË 1 (EL-1)	-	15,50 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	0,100 (denarë/kilogram)

Neni 8

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e sjelljes së tij, publikohet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe në faqen zyrtare të Komisionit Rregullator të Energjetikës, të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe do të zbatohet nga ora 00:01 datë 2.6.2026.

Me këtë vendim bëhet ulja e çmimeve të shitjes me pakicë të derivateve të naftës mesatarisht për 3,84% në raport me çmimet e shitjes me pakicë të derivateve të naftës, të përcaktuara në përputhje me vendimin për përcaktimin e çmimeve më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit të Komisionit Rregullator të Energjetikës, të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga data 26.5.2026.

Çmimet referente të derivateve të naftës në tregun botëror, në krahasim me përlogaritjen e mëparshme, shënojnë ulje të benzina mesatarisht 10,867% ose për 126,900 \$/t, të nafta ulja është mesatarisht 10,622% ose 125,300 \$/t, të vaji ekstra i lehtë ulja është mesatarisht 10,136% ose për 118,400 \$/t dhe të mazuti ulja është mesatarisht 8,238 ose për 51,900 \$/t.

Kursi i denarit në raport me dollarin në periudhën e kaluar, mesatarisht është 53,1138 den/\$ dhe është rreth 0,0272% më i lartë se kursi i dollarit (53,0994 den/\$) sipas të cilit janë formuar çmimet me përlogaritjen e mëparshme, respektivisht nga data 26 maj.

Në seancën e mbajtur më 31.5.2026, Qeveria e RMV-së solli Vendimin për Ndryshimin e Vendimit për Përcaktimin e Llojit të Burimeve Energjetike, Periudhës Kohore dhe Mënyrës së Përlogaritjes së Akcizës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 115/26). Me vendimin për ndryshimin e Vendimit për Përcaktimin e Llojit të Burimeve Energjetike, Periudhës Kohore, si dhe Mënyrës së Përlogaritjes së Akcizës, mundësohet zbatimi i shumave më të ulëta të akcizave për 2,00 den/l tek EUROSUPER BS-95 dhe EUROSUPER BS-98, në përputhje me nenin 92, paragrafi 11 të Ligjit të Akcizave, ndërsa të përlogaritura në përputhje me çmimin mesatar ditor të bursës të Prem Unl 10ppm në kuotimin "Mediterranean cargoes FOB (Italy)" nga Platt's European Marketscan, për periudhën nga data 16 deri më 31 maj 2026 dhe çmimin mesatar ditor të busës të 10 ppm ULSD në kuotimin "Mediterranean cargoes FOB (Italy)" të Platt's European Marketscan, për periudhën nga data 16 deri më 31 maj 2026. Norma e privilegjuar tatimore për TVSH-në është 18% për të gjitha derivatet e naftës, përfshirë edhe derivatet e naftës EUROSUPER BS-95 dhe EUROSUPER BS-98.

Duke pasur parasysh ndikimet e këtyre elementeve në formimin e çmimeve të derivateve të naftës në përputhje me Metodologjinë, çmimet e shitjes me pakicë të derivateve të naftës ulen mesatarisht për 3,84 %.

Çmimet e shitjes me pakicë të benzinës EUROSUPER BS-95 dhe EUROSUPER BS-98, rriten për 0,50 denarë/litër, në raport me çmimet e shitjes me pakicë, të përcaktuara me vendimin e përcaktimit të çmimeve më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit të datës 26.5.2026 kështu që çmimi i shitjes me pakicë i EUROSUPERIT BS-95 është 88,00 den/litër, ndërsa çmimi i shitjes me pakicë i EUROSUPERIT BS-98 është 90,00 den/litër.

Çmimet e shitjes me pakicë të EUROSUPERIT (D-E V) dhe të Vajit Ekstra të Lehtë për Amvisëri (EL-1) ulen për 6,50 denarë/litër, në raport me çmimet e shitjes me pakicë, të përcaktuara me vendimin për përcaktimin e çmimeve më të larta të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse për transport të datës 26.5.2026 kështu që çmimi i shitjes me pakicë i EUROSUPERIT (D-E V) është 85,50 den/lit, ndërsa çmimi i shitjes me pakicë i VAJIT EKSTRA TË LEHTË PËR AMVISËRI (EL-1), është 87,50 den/lit.

Çmimi i shitjes me pakicë i Mazutit M-1 SU ulet për 3,238 denarë/kilogram, në raport me çmimin e shitjes me pakicë, të përcaktuar me vendimin e përcaktimit të çmimeve më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit të datës 26.5.2026 kështu që çmimi i shitjes me pakicë i Mazutit M-1 SU është 47,906 den/kg.

Бр.02-853/1

1.6.2026

С к о п ј е

Ш к и п

Заменик претседател на Регулаторна комисија за енергетика, водни услуги и услуги за управување со комунален отпад на Република Северна Македонија

Zëvendëskryetari i Komisionit Rregullator të Energjetikës, të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturinat Komunale të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Lirim Sulejmani